

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë,08.04.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.4.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "RISA MONT SHPK", për aktivitetin: "Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik Nr. të Prok: 616 21 019 211 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "RISA MONT SHPK" e datës 02.04.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik Nr. të Prok: 616 21 019 211 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit , të datës 17.03.2021 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë aktivitetin sipas publikimit të datës 17.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "RISA MONT SHPK" me datë 02.04.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik Nr. të Prok: 616 21 019 211**

Autoriteti Kontraktues, me datë 08.04.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet e parashtuesit të kërkesës për rishqyrtim lidhur me mostrat dhe çertifikatat e noterizuara janë të pa bazuara, pasi që Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik me datën


12.06.2020 ka publikuar Njoftimin numer 47/2020 sipas te cilit çfuqizohen Njoftimet numer 40/2020,41/2020 dhe 42/2020 sipas te cilave ka qene e ndaluar kerkimi i katalogjeve,mostrave dhe dokumenteve te noterizuara.Pra nga kjo rrjedh se kerkesat tona ne FDT jane ne harmoni me dispozitat ligjore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit